



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Nr. 1682 Prot.

Tiranë, më 26.03 2019

Lënda: Kërkesë për plotësim dokumentacioni

PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

Adresa: Sheshi "Austria", Tiranë

Për dijeni:

KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë

ZNJ. NAJADA HAJDAR SHATRO

Adresa: Këshilli i Bashkisë Vlorë

Me shkresën nr. 2177 prot., datë 13.03.2019, Këshilli i Bashkisë Vlorë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, në Këshill, vakancë kjo e krijuar nga Këshilltari, z.Ted Kristaq Nasto, propozuar nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Vlorë, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit, është kandidati me numër rendor 29, znj.Najada Hajdar Shatro.

Referuar nenit 11, të ligjit nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për çdo kandidat të listave shumemërore për këshillin bashkiak për shkak të plotësimit të vakancave duhet të kryhet, vetëdeklarimi për garantimin e integritetit dhe verifikimi i të dhënave.

Përpara plotësimit të vakancës në Këshillin e Bashkisë Vlorë, kandidati i listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, znj.Najada Hajdar Shatro, duhet të depozitojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 10 ditëve formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 162 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" ka vendosur të bëjë njoftimin e kandidatit, nëpërmjet afishimit publik, për shkak të pamundësisë së gjetjes së një adrese të saktë për të bërë njoftimin e saj. Kjo shpallje do të publikohet edhe në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



Me afishimin e kësaj shpallje, kandidatët vihet në dijeni për njoftimin e tyre për dorëzimin e formularit të vetëdeklarimit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Afati i dorëzimit fillon nga data e publikimit të kësaj shpallje.

Nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit të sipërcituar, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje apo emërim.

Ju bëjmë me dije se formulari i vetëdeklarimit duhet të jetë i plotësuar në kompjuter, në të gjitha seksionet e tij dhe në rast se ndonjë nga pjesët e formularit nuk mund të plotësohet, për mungesë të faktit, atëherë personi duhet të shënojë me vizë (/) atë pjesë, në mënyrë që të shmanget plotësimi apo rregullimi i mëvonshëm i saj, në përputhje me Kreun II, pika 7, dhe Kreun III pika 2, e Vendimit të Kuvendit nr.17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".


KRYETAR
Klement ZGURI

